



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:144752
Datë: 02.09.2024
Numri i dokumentit: 06111080

K.DH.SH.II.nr.1501/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “T...” Sh.p.k me numër unik identifikues të biznesit ... me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, lidhur me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit-propozuesit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, K.A.nr.239/24 të datës 24.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit “T...” Sh.p.k me numër unik identifikues të biznesit ... me seli në Fushë Kosovë, ndërsa VËRTETOHET Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, K.A.nr.239/24 të datës 24.05.2024.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, është vendosur si në vijim;

I. “REFUZOHET propozimi-kërkesa e paditësit “T...” Sh.p.k me numër unik identifikues të biznesit ... me seli në Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.2024/0227 të datës 17.05.2024 të nxjerrë nga Paneli Shqyrtues i të paditurës Organi Shqyrtues i prokurimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar me padi.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet aktvendimi KA.nr.23/24 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative i datës 24.05.2024, të miratohet propozimi i propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit të datës 17.05.2024 me shenjën 2024/0227. Të detyrohet Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme që të pezulloj aktivitetin e prokurimit “Furnizim me targa për regjistrimin e Automjeteve” me nr. prokurimit 214-22-12927-1-1-1, duke përfshirë edhe pezullimin e kontratës së lidhur përmes këtij aktiviteti të prokurimit, deri në përfundimin e kësaj procedure gjyqësore.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë e paditura edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datën 12.07.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi “T...” Sh.p.k me numër unik identifikues të biznesit ... me seli në Fushë Kosovë, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, ndaj vendimit PSH.nr.2024/0227 të datës 17.05.2024. Padiësi së bashku me padi, ka propozuar - kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.2024/0227 të datës 17.05.2024.

Dhoma e Shkallës së Parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që padiësi nuk e ka argumentuar faktin se ekzekutimi i vendimit do të sillte dëm i cili vështirë do të riparohej, si dhe nuk ka argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së. Pa paragjykuar ligjshmërinë e vendimit kontestues që bie në kompetencë të procedurës së rregullt administrative, gjykata në këtë rast vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ndërsa lidhur me pretendimet tjera të paraqitura në padi sa i përket ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas shqyrtimit të kërkesëpadisë dhe administrimit të provave të propozuara në seancë publike, por që këto pretendime dhe prova nuk janë me ndikim me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm padiësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do të sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret padiësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.2024/0227 të datës 17.05.2024, e lëshuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, deri në vendosjen meritore të kërkesëpadisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, të cilat pretendime janë që gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Departamenti Për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme lidhur me atë se në rast se nuk do të shtyhet ekzekutimi i vendimit paditësit do ti shkaktohej dëm i riparueshëm dhe dëmi jo material për shkak të dëmtimit të imazhit të kompanisë por edhe fitim i humbur që në rastin konkret do të ishte së paku i barasvlefshëm ose më i lartë se sa vlera e parashikuar e tenderit, pra totali i dëmeve që paditësit do ti shkaktohen janë mbi 6 milion euro, padyshim që ky dëm i paditësit do të jetë vështirë i riparueshëm pasi që bëhet fjalë për një shumë të konsiderueshme që është ngarkesë mjaftë e madhe për buxhetin e shtetit. Kolegji në këtë rast vlerëson se realizimi i një projekti në procedurë të prokurimit është një rrethanë e ardhshme e pasigurte dhe se fati i të cilën nuk e përcakton realizimin e veprimtarisë së rregullt afaristë, ngase paditësi me vet faktin e aplikimit nuk konsiderohet fitues i kontratës, po ashtu kolegji i kësaj gjykate vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim ndryshe në vendosje lidhur më këtë rast, andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Po ashtu edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nga provat e bashkangjitura në propozim nuk e arsyetojnë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast, ngase nuk dëshmojnë se pa shtyrjen e vendimit kontestues do të shkaktonte dëm të riparueshëm apo se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, andaj paditësi-propozuesi me prova të cilat ja ka bashkëngjit kërkesës në fjalë nuk janë bindëse dhe nuk e mbështetin pretendimet e paditësit-propozuesit se ekziston mundësia e shkakimit të dëmit apo humbje të tilla, kështu, kolegji i kësaj gjykate erdh në përfundim se propozuesi-paditësi kërkesën për shtyrje të ekzekutimit nuk e ka bërë të besueshme me prova bindëse dhe konkrete, që me ekzekutimin e vendimit kontestues do të mund të shkaktohet ndonjë dëm të riparueshëm, e cila do të mund të riparohej me vështirësi, ashtu siç parashihet me nenin 22 paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2 të LKA-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 1501/24 datë 02.09.2024

Kryetarja e Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri